

Punonjësit Portualë - “ Kush dhuron gjak, shpëton një jetë”

14 Nëntor 2011



Autoriteti Portual Durrës, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar kanë organizuar fushatën për dhurimin vullnetar të gjakut nga punonjësit e tij.

Dhurimi vullnetar i gjakut do të kryhet ditën e hënë, më 14 nëntor, ora 12.00 në mjediset e Qendrës së Trajnimeve të Autoritetit Portual.

“ Kush dhuron gjak, shpëton një jetë” është moto e kësaj nisme.

Organizimi i dhurimit të gjakut

Dhurimi i gjakut do të bëhet në kushte optimale higjienike. Procesi do të ndiqet nga një ekip i specializuar mjeksor.

Dhuruesit në fillim do t'i matet tensioni arterial, temperatura dhe niveli i hemoglobinës për t'u siguruar nëse ai është në gjendje të mirë shëndetsore në momentin e dhurimit të gjakut.

Jashtë ambienteve të Qendrës së Trajnimeve do të jetë në gadishmëri të plotë autoambulanca e portit, e cila do të asistojë në rast nevojë për dhuruesit e gjakut. I pranishëm do të jetë dhe stafi mjeksor i portit me një personel të përhershëm të përbërë nga 3 mjekë, 2 ndihmësmjekë dhe dy shoferë , të gatshëm të përballojnë ndihmën e parë dhe rastet e emergjencave mjeksore.

Stafi drejtues i Autoritetit portual ka konfirmuar pjesmarrjen për dhurimin e gjakut. Vazhdon të rritet numri i vullnetarëve dhurues të gjakut.

